

Abdulatif ARNAUTI

HASAN KALESHI - NJË PREJ PERSONALITETEVE MË TË NJOHURA TË KULTURËS ISLAME DHE ARABE NË BALLKAN

*Marrë nga revista "Haxhi dhe Umreja", Nr 11, Viti i 61 i botimit
(Dhul Ka'de 1427- Mbretëri e Arabisë Saudite)*

Më 19 korrik të vitit 1976, u nda nga jeta një personalitet tepër i njohur i shkencës, me kombësi shqiptare, vepra e të cilit përbën një kontribut të pallogaritshëm në fushën e studimeve islamike dhe orientalistike. Ky ishte doktor Hasan Kaleshi, një figurë realisht dinjitoze, e cila la gjurmë të ndritshme në fushën e studimeve orientale, por që, me ndarjen e tij nga jeta, krijoi një boshllëk të pazëvendësueshëm për të gjithë. Zakonisht, kur bëhet fjalë për Orientalistikën, bota arabe kthen vështrimin e saj menjëherë drejt orientalistëve më në zë të perëndimit, edhe pse vlen të përmendet fakti që përherë e ka shoqëruar një ndjenjë e theksuar dyshimi ndaj tyre. Ndërkohë, kur bëhet fjalë për burime të studimeve orientale në shtetet e Evropës Lindore ku, padyshim, një rol themelor e pozitiv në këtë drejtim luajti feja islame, ndodh e kundërta, pasi rrallëherë është evidentuar një interesim serioz nga bota arabe ndaj këtyre vende.

Dr. Hasan Kaleshi, si një orientalist i kulluar, kurrë nuk e ngatërroi jetën e tij me ambicie politike dhe mbeti njëkohësisht besnik i fakteve shkencore dhe studiues i mirëfilltë. Faktor tjetër i rëndësishëm në jetën e tij dhe që, përbënte një veçori në fushën e studimeve, ku u bë i njohur ky personalitet shqiptar, ishte identiteti fetar, i cili qe urë lidhëse midis këtyre vendeve ballkanike, prej nga ishte vetë dr. Kaleshi, dhe botës arabe. Nisur nga kjo përvojë jetësore, ai u gjend në krah të Lëvizjes Orientalistike apo studimeve arabo-islamike, duke ofruar thesare të reja, me produktin e tij në fushat respektive që, për nga vlerat

që përfaqëson, meriton një përkujdesje dhe interesim të veçantë. Me veprën dhe kontributin e tij në fushën e Orientalistikës, ai u vlerësua si një nga emblemat e shquara të saj.

Biografia e Dr. Hasan Kaleshit

Dr. Hasan Kaleshi lindi në fshatin Serbetinë në Maqedoninë perëndimore, në gjirin e një familjeje me origjinë shqiptare, shumë tradicionale për nga aspekti i ruajtjes së vlerave dhe identitetit kombëtar. Gjyshi i tij quhej Ali Kaleshi dhe ishte një prej emrave më të njohur të dijetarëve të fesë islame në zonë, pasi kishte përfunduar studimet teologjike në Stamboll. Po kështu dhe i ati i tij, duke ndjekur vijën e gjyshit në përvetësimin e kulturës islame, përfundoi studimet teologjike në Medresenë e Fatihut në Stamboll. Pra, në mes të një ambienti kulture dhe vlerash islame, u rrit ky fëmijë, nën përkujdesjen e vazhdueshme të të atit, që e nxiste të mësonte Kuranin Famëlartë dhe gjuhën arabe qysh në moshë fare të njomë, atë gjashtëvjeçare. Me gjithë këtë përkujdesje, përsëri i ati e regjistroi në shkollën publike në vendlindjen e tij. Shkollimin para të mesëm dhe të mesëm e kreu në Shkup, pasi familja e tij u transferua në këtë qytet. Shkolla, ku studionte djaloshi Hasan Kaleshi, u mbyll pas shpërthimit të Luftës II Botërore, kështu që u detyrua të përfundonte shkollimin në qytetin e Prishtinës – Kosovë. Më pas, u thirr në vendlindje, në fshatin Serbetinë, për të punuar si përkthyes në administratën e vendit.

Pas përfundimit të Luftës dhe formimit të shtetit jugosllav, në vitin 1943, ai u regjistrua në Universitetin e Beogradit për të ndjekur studimet e larta në degën e orientalistikës, ku dhe u diplomua në vitin 1952. Për rezultatet e tij të shkëlqyera, u caktua asistent-profesor në Universitet, por në kushtet e një trysnie të vazhdueshme që vazhdonte ndaj popullsisë me përkatësi islame në Jugosllavi, u detyrua të emigrojë në Turqi me gjithë familjen e tij. Pavarësisht kësaj, titujt “Master” dhe “Doktor” iu akorduan nga Universiteti i Beogradit, ku dhe mbrojti disertacionin e titulluar “Dokumentet më të hershme të vakëfeve në gjuhën arabe, për zonën e Maqedonisë”. Më vonë, megjithë përpjekjet e tij për t’u emëruar profesor asistent në Universitetin ku kishte studiuar vetë, nuk pati sukses, për shkak të origjinës së tij

shqiptare, e cila, në këndvështrimin e shtetit të atëhershëm jugosllav, përbënte një pengesë serioze, pasi trajtohej në fokusin e mosmarrëveshjeve ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë, që asokohe kishin arritur kulmin e tyre. Përveç kësaj, ai ishte musliman, në një periudhë kur e gjithë Jugosllavia ndiqte një politikë nacionaliste nën motivin "e serbizimit të saj". Nuk u vlerësua as fakti që vetë dr. Kaleshi ishte martuar me një grua serbe. Megjithë situatën e vështirë që mbizotëronte, ai zgjodhi një drejtim shkencor që faktikisht ishte shumë larg politikës, e cila nuk përbënte për të kurrfarë interesi. Megjithatë, edhe në këto kushte të vështira, ai ia doli mbanë: afirmoi veten fuqishëm si studiues dhe hulumtues i mirëfilltë, që ia vlente për t'u marrë shembull, për kulturën dhe njohuritë e tij të thella në shkencat arabo-islamike.

Bazuar mbi të kaluarën dhe përvojën e shkollimit të tij, dr. Kaleshi arriti të zotëronte mjaft mirë disa gjuhë të huaja, si: shqip, maqedonisht, turqisht, serbisht, arabisht, gjermanisht, anglisht, frëngjisht, italisht etj., të cilat i mundësuan të publikonte studimet e veta në shumë gjuhë. Por kjo larmi gjuhësh të zotëruara, nga njëra anë ndikuan drejtpërdrejt në çpërqëndrimin e energjive të tij, pasi veçse për pak nga këto studime në gjuhë të huaj, u mundësua përkthimi i tyre në gjuhën amtare të autorit. Nga ana tjetër, këto gjuhë të huaja ishin një faktor i rëndësishëm ndihmës, ato i dhanë autorit një famë të admirueshme në nivel ndërkombëtar, duke e promovuar atë si një orientalist tepër të aftë, që përfaqësonte shembullin e unifikimit të Orientalistikës Perëndimore dhe veçorive të saj me Orientalistikën Lindore, me metodat dhe parimet e saj tradicionale. Njohuritë e gjera që mbarnte mbi supe, kultura dhe niveli intelektual i mundësuan dr. Hasan Kaleshit zgjerimin e vazhdueshëm të horizonteve të tij, po ashtu një optikë më të thellë në rrafshin studimor si dhe e dalluan atë për nga mënyra e qasjes së studimeve të tij të gjithanshme. Këto afirmuan, pa mëdyshje, figurën e këtij akademiku, duke merituar plotësisht notat vlerësuese më pozitive.

Në vitin 1965 kthehet në Jugosllavi dhe punon në Institutin e Studimeve Albanologjike në Prishtinë. Vazhdoi aty deri në vitin 1973, vit në të cilin zgjidhet Shef i Departamentit të

Orientalistikës në Universitetin e Kosovës. Ndërron jetë pas tre vjetësh, në 1976.

Dr. Hasan Kaleshi ishte pedagog i gjuhës dhe literaturës arabe. Ka publikuar një sërë studimesh të tij në revista, që trajtojnë çështje të Orientalistikës e gjithashtu çështje të vendit dhe të huaja. Ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare për Orientalistikën. Në Egjipt ai pati fatin të takojë shumë nga shkrimtarët, të cilëve u kishte shërbyer, duke përkthyer pjesë nga veprat e tyre, si: Mahmud Tejmur, Teufik Al-Hakim etj. Ai, gjithashtu, zhvilloi biseda të drejtpërdrejta të fokusuara në lëmin e profilit të tij si orientalist.

Vepra letrare

Gjatë periudhës 1949-1976 dr. Kaleshi shkroi dhe publikoi shumë studime dhe kërkime të rëndësishme në gjuhë të ndryshme. Një pjesë të madhe prej tyre nuk mundi t'i përkthejë prej gjuhëve në të cilat u publikuan. Ndërkohë që disa prej tyre kanë humbur, pjesa tjetër është grupuar në një seri vëllimesh. Numri i studimeve dhe kërkimeve të realizuara i kalon 350, pa përfshirë këtu librat e botuar. Këto studime përfaqësojnë më së miri interesimin intelektual dhe përkujdesjen e dr. Hasan Kaleshit në fushën studimore të kulturës orientale, të cilën mund ta ndajmë në tri kategori:

1. Trashëgimia kulturore shqiptare – Gjuha dhe literatura shqipe.
2. Trashëgimia kulturore arabo-islamike.
3. Trashëgimia kulturore osmano-turke.

Gjuha dhe literatura shqipe

Gjatë viteve '50 të shekullit të shkuar, menjëherë pas diplomimit, dr. Hasan Kaleshi shfaqti një interesim të veçantë për gjuhën shqipe. Studimin e tij të parë në gjuhën shqipe e publikoi në vitin 1949. Ai titullohej "Vërejtje rreth gjuhës së përdorur në gazetarinë tonë". Më 1952 publikon studim-artikullin me temë: "Letërsia bashkëkohore shqipe në Jugosllavi", me synimin për t'ua ekspozuar letërsinë shqipe sa më shumë popujve të tjerë jugosllavë. Në vitin 1957 botoi artikullin me temë "Letërsia e shkruar shqipe me shkrim arab". Lëvroi në masë

Orientalistikës në Universitetin e Kosovës. Ndërron jetë pas tre vjetësh, në 1976.

Dr. Hasan Kaleshi ishte pedagog i gjuhës dhe literaturës arabe. Ka publikuar një sërë studimesh të tij në revista, që trajtojnë çështje të Orientalistikës e gjithashtu çështje të vendit dhe të huaja. Ka marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare për Orientalistikën. Në Egjipt ai pati fatin të takojë shumë nga shkrimtarët, të cilëve u kishte shërbyer, duke përkthyer pjesë nga veprat e tyre, si: Mahmud Tejmur, Teufik Al-Hakim etj. Ai, gjithashtu, zhvilloi biseda të drejtpërdrejta të fokusuara në lëmin e profilit të tij si orientalist.

Vepra letrare

Gjatë periudhës 1949-1976 dr. Kaleshi shkroi dhe publikoi shumë studime dhe kërkime të rëndësishme në gjuhë të ndryshme. Një pjesë të madhe prej tyre nuk mundi t'i përkthejë prej gjuhëve në të cilat u publikuan. Ndërkohë që disa prej tyre kanë humbur, pjesa tjetër është grupuar në një seri vëllimesh. Numri i studimeve dhe kërkimeve të realizuara i kalon 350, pa përfshirë këtu librat e botuar. Këto studime përfaqësojnë më së miri interesimin intelektual dhe përkujdesjen e dr. Hasan Kaleshit në fushën studimore të kulturës orientale, të cilën mund ta ndajmë në tri kategori:

1. Trashëgimia kulturore shqiptare – Gjuha dhe literatura shqipe.
2. Trashëgimia kulturore arabo-islamike.
3. Trashëgimia kulturore osmano-turke.

Gjuha dhe literatura shqipe

Gjatë viteve '50 të shekullit të shkuar, menjëherë pas diplomimit, dr. Hasan Kaleshi shfaqti një interesim të veçantë për gjuhën shqipe. Studimin e tij të parë në gjuhën shqipe e publikoi në vitin 1949. Ai titullohej "Vërejtje rreth gjuhës së përdorur në gazetarinë tonë". Më 1952 publikon studim-artikullin me temë: "Letërsia bashkëkohore shqipe në Jugosllavi", me synimin për t'ua ekspozuar letërsinë shqipe sa më shumë popujve të tjerë jugosllavë. Në vitin 1957 botoi artikullin me temë "Letërsia e shkruar shqipe me shkrim arab". Lëvroi në masë

letërsinë popullore shqipe; ndërmori një studim krahasues mbi figurën e famshme të Nastradinit, mbi pjesë të rralla të shkrimtarit të madh shqiptar Sami Frashërit, si dhe mbi rrëfenjat popullore shqipe. Punoi një sërë artikujsh për figura të shquara shqiptare, që kanë spikatur gjatë historisë së Perandorisë Osmane; është marrë me korrigjimin e shumë fakteve të lidhura me historinë osmane-shqiptare, si dhe ka publikuar dokumente historike që flasin rreth kryengritjeve kombëtare shqiptare të periudhës 1909-1912.

Trashëgimia kulturore arabo-islamike

Përveç përgjegjësisë së mësimdhënies së gjuhës arabe dhe funksioneve në të cilat punoi, dr. Hasan Kaleshi pati ndikim të fuqishëm në promovimin e literaturës arabe nëpërmjet përkthimit të shumë kryeveprave të letërsisë bashkëkohore dhe klasike arabe. Gjithashtu, ai punoi shumë studime dhe analiza të vyeshme rreth kësaj letërsie. Ka përkthyer në gjuhë të ndryshme të rajonit një mori letrarësh arabë, si: Ibni Rumi, Xhubran Khalil Xhubran, Bulend El-Hajderi, Nizar Kabbani, Sulejman Al-Isa etj. Ka publikuar studime të veçanta në kuadër të letërsisë arabe, si: "Letërsia bashkëkohore egjiptiane" 1956, "Risitë në poezinë moderne arabe" 1965. Ka përkthyer një seri tregimesh të shkrimtarit të njohur arab Mahmud Tejmur, si dhe ka përgatitur një tekst universitar që trajton Historinë e Letërsisë Arabe, të cilin ia propozoi Rektoratit të Universitetit të Kosovës, por që, për ironi të fatit, ky dorëshkrim nuk u publikua.

Interesimi i dr. Kaleshit në studimet gjuhësore dhe të leksikut del në pah shumë qartë në studimin prej tij të gjuhëve serbe, shqipe dhe turke, e, gjithashtu, në pasqyrimin që u bëri veprave të shkrimtarit dhe studiuesit enciklopedik shqiptar, Sami Frashëri. Në kryeveprat e realizuara nga dr. Hasan Kaleshi, bën pjesë dhe "Fjalori serbokroatisht-arabisht", të cilin e përfundoi me sukses në bashkëpunim me studiuesin e njohur Kamil El-Buhi, një ndër personalitetet më të njohura të fushës së Orientalistikës gjatë viteve '50. Fjalori doli nga shtypi pas ndarjes nga jeta të të dy autorëve. Ai përfshin rreth 50 mijë fjalë e idioma në të dyja gjuhët dhe pati ndikim të jashtëzakonshëm në brezat që erdhën më pas në përhapjen dhe lehtësimin e mësimin të

gjuhës arabe nga popujt serbo-kroatishtfolës.

Një prej sektorëve ku u shqua orientalisti Hasan Kaleshi, ishte verifikimi dhe publikimi i dokumenteve të vakëfeve, pasi kjo përfshihej në specialitetin e tij shkencor. Në mënyrë të veçantë, ai mbuloi sektorin e vakëfeve të regjistruara në gjuhën arabe, i mblodhi dhe i botoi ato në një libër të veçantë, i cili doli nga shtypi në vitin 1972 me titull "Dokumentacion në arabisht i vakëfeve në Republikën Federative Jugosllave". Ky libër njohu një shpërndarje të gjerë në mjediset e bibliotekave private dhe shkollore, si dhe nëpër xhami dhe institucione të ndryshme fetare.

Trashëgimia kulturore osmano-turke

Orientalisti Hasan Kaleshi, midis larmisë së gjuhëve që zotëronte, mësoi edhe gjuhën turke gjatë qëndrimit të tij në Shkup, Beograd dhe Stamboll. Në fushën e studimeve osmano-turke bashkëpunoi dhe përfitoi nga përvoja e studiuesve më të njohur. Publikoi një sërë artikujsh e studimesh në serbisht, arabisht dhe shqip, me të cilat synonte të bënte të njohur literaturën e vjetër dhe të re turke, e, njëkohësisht, përktheu vepra të shkrimtarëve më të shquar osmanë. Arritja më e madhe në këtë fushë për dr. Hasan Kaleshi ishte vlerësimi i tij, nëpërmjet pasqyrimit të jetës dhe veprës së një prej figurave më të mëdha, siç ishte ajo e dr. Ibrahim Temo, themelues i "Organizatës për Unitet dhe Zhvillim", e cila luajti rol të rëndësishëm politik në sistemin e pushtetit osman, si dhe në marrjen e këtij të fundit nga Qemal Ataturku. Studimi me titull "Faqja tjetër e unitetit dhe zhvillimit" u publikua në disa gjuhë, si në gjermanisht, serbokroatisht dhe arabisht. Autori, me analizën e tij, i ndriçon të dyja frontet e "Lëvizjes për Unitet e Zhvillim", njëra prej të cilave ishte fronti Turani, që përfaqësonte një lëvizje tradicionale me tipare të theksuara nacionaliste turke. Fronti tjetër, që përfaqësohej me vetë themeluesin e Lëvizjes për Unitet e Zhvillim, dr. Ibrahim Temo, ishte për bashkimin e gjithë popujve që përfshiheshin në administrimin perandorak, nën flamurin e pushtetit osman në drejtimin e një shteti federal, duke i dhënë gjithsecilit të drejta kombëtare, përfshi këtu një formë të vetëqeverisjes administrative, të drejtën për mësimin e gjuhës amtare të secilit në kuadër të shtetit osman, ku përfshiheshin

shtetet e Ballkanit dhe disa shtete arabe. Ndoshta ne, në ditët e sotme, nuk dimë shumë për këtë aspekt tjetër të fronteve të "Lëvizjes për Unitet e Zhvillim" të themeluar në sajë të përpjekjeve në atë periudhë të dr. Temos, një mjek okulist në Shqipëri, i cili ishte ndikuar nga veprat e liberalizmit perëndimor, që bënin thirrje për liri të mendimit dhe nxitje të hapave të zhvillimit e të progresit tek ideologët dhe intelektualët turq, si p.sh., intelektual i Namik Kemal. Vlen të përmendet se organizata "Lëvizja për Unitet dhe Zhvillim" u themelua thuajse në një mënyrë identike me atë të organizatës ilegale "Karbonara" të Italisë, si dhe në ndikimin e Masonerisë dhe organizimeve të tyre të fshehta.

Ky aspekt tjetër i lëvizjes përfaqësonte zërin e përpjekjeve të popujve joturq, në ngritjen dhe organizimin në shoqata homologe apo degë të organizatës mëmë në vende të tjera, siç ishte shembulli i organizatave që u themeluan në vendet arabe dhe që, për hir të së vërtetës, i bënë një rezistencë të madhe pushtetit osman. Me këtë studim të realizuar, dr. Hasan Kaleshi mundi të zbulojë një sërë faktesh dhe të vërtetash historike të rëndësishme rreth kësaj organizate, për të cilën nuk mund të lihet pa thënë se ndryshoi fatin e shumë popujve në fillimshkullin XX.

Dr. Hasan Kaleshi dhe kultura arabe

Orientalisti Hasan Kaleshi e dashuroi me tërë forcën gjuhën dhe trashëgiminë kulturore arabe, sa që përgjatë gjithë jetës së tij, nëpërmjet studimeve dhe opinioneve të veta, u përkujdes për promovimin dhe mbështetjen e kulturës arabe, ashtu siç u përpoq njëkohësisht për forcimin e relacioneve që i bashkonin vendet muslimane të Ballkanit me popullin e madh arab. Nuk ka si të mos bjerë në sy që opinionet e dr. Kaleshit, të dhëna në një intervistë të realizuar me dr. Ali Shelesh, gjatë vizitës që zhvilloi në Kajro (viti 1965), reflektonin sinqeritet maksimal dhe interesim të pashembullt në studimin e trashëgimisë kulturore arabe. Njëkohësisht, ajo mbeti një dëshmi e gjallë e pjekurisë intelektuale si dhe shenjë e lexueshme e mendjemprehtësisë dhe forcës së argumentimit të tij. Dr. Kaleshi fliste për lidhjen ndërmjet popujve të Ballkanit dhe popujve arabë qysh herët,

para se të mbërrinin turqit në rajonin e Ballkanit. Ai përmendte se, në veri të Jugosllavisë, para shekullit XIV ekzistonin komunitete muslimanësh, anëtarët e të cilit i thërrisnin me emrin "Ismailitë" dhe nuk lë pa theksuar rolin që kanë luajtur "Sicilianët" jugosllavë, në Andaluzinë e periudhës arabe. Gjatë asaj interviste dr. Kaleshi ceku një fakt tjetër shumë interesant: Xhevher Sakli, ndërtuesi i Kajros, ishte me origjinë ballkanase.

Duke folur për këto lidhje të ngushta që ekzistonin midis popujve, dr. Kaleshi theksonte ndikimin e trashëgimisë kulturore arabe në kulturën e popujve muslimanë të Ballkanit, rolin e drejtpërdrejtë që ka luajtur pelegrinazhi në vendet e shenja, bibliotekat dhe literatura arabe e fushave të ndryshme në përhapjen e kulturës arabe qysh në shekullin XIV, si dhe ndikimin që pati gjuha arabe, folklori, arkitektura arabo-islamike në artet dhe gjuhët e Ballkanit. Këtu, nuk mund të përjashtonte pa përmendur kurrsesi, përkthimin si një nga faktorët më të rëndësishëm të njohjes me letërsinë arabe dhe kulturën në përgjithësi. Ai nxiste për një interesim më të madh dhe përkujdesje të veçantë për letërsinë bashkëkohore arabe e cila, edhe pse në ndryshim nga ajo letërsi e hershme dhe tradicionale në stil, formë dhe gjuhë, përbënte në vetvete një vlerë që nuk qëndronte më poshtë sesa letërsia e hershme (pasi çështja ka të bëjë fund e krye me personalitetin e poetit, ndjenja që përjeton, forca e tij poetike dhe përvoja e tij jetësore). Dr. Kaleshi thoshte që ka poetë, vepra poetike e të cilëve nuk mund të klasifikohet as në letërsinë e hershme-tradicionale, as në poezinë bashkëkohore, për shkak të stilit të veçantë të të shprehurit që ka poezia e tyre e, megjithatë, këta autorë kanë vendin e tyre të pamohueshëm në këtë mes. Dr. Kaleshi ishte i mendimit që proza e letërsisë bashkëkohore arabe duhet të ketë një kriter të veçantë vlerësimi: nivelin me të cilin kjo lëmi letrare, pasqyron realitetin dhe shfaq reagimin e saj ndaj çështjeve të rëndësishme humane.

Këto kritere vlerësimi, pa dyshim që i sigurojnë këtij lloji letrar vendin e merituar në letërsinë botërore, megjithëse vlen të përmendet se letërsia bashkëkohore arabe njohu njëfarë suksesi të vlerësueshëm, duke bashkërendur me zhvillimet progresiste, vetëm se problemi i përhapjes së letërsisë arabe në botë nuk

qëndron këtu, por fshihet në marketingun që i bëhet produktit letrar.

Dr. Kaleshi merr dhe krahason realitetin e gjuhës arabe dhe atë të gjuhëve sllave, siç thekson dukurinë e bashkëjetesës ndërmjet gjuhës letrare arabe dhe asaj të folur, e cila vërteton rrënjët e thella të këtyre gjuhëve si dhe dialektet e ndryshme që kanë lindur prej tyre, në një kohë kur gjuha sllave, siç përmend dr. Kaleshi, është një gjuhë e re, ku nuk ka dallim mes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Ai është kundër idesë së zëvendësimit të shkronjave latine me ato arabe në shkrimin ballkanas, për faktin e vështirësisë reale që haset në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në larminë me të cilën na paraqitet ky shkrim. Dr. Kaleshi e argumenton brishtësinë e kësaj ideje, duke përmendur rastin e shkrimit japonez që, me gjithë numrin e madh të gërmave dhe stilet e ndryshme të shkrimit, përsëri bijtë e këtij kombi vazhdojnë ta mësojnë atë pa ndonjë vështirësi dhe vështirë të gjesh analfabetizëm në mesin e tyre.

Në të njëjtën kohë, dr. Kaleshi shpreh deri në njëfarë niveli rezervat e tij në përdorimin e gjuhës së përditshme në letërsinë e shkruar, si dhe është i mendimit që përdorimi i kësaj gjuhe në skenën e teatrit duhet të jetë i balancuar, që të mos i jepet askujt përparësi në dëm të tjetrës.

Për konsolidimin e lidhjeve kulturore midis popujve arabë dhe atyre ballkanikë, dr. Hasan Kaleshi është i mendimit se shkëmbimi i vizitave, intervistave dhe opinioneve midis intelektualëve, shkrimtarëve dhe studiuesve të këtyre vendeve, janë elementet më pozitive që mund t'i ngrenë dhe forcojnë urat e bashkëpunimit kulturor dhe të marrëdhënieve respektive.

Për sa i përket fushës studimore dhe kërkimore, dr. Kaleshi bën një krahasim midis dy rajoneve dhe arrin në idenë që puna studimore dhe kërkimore në vendet arabe ka karakter individual dhe konkretizohet në përpjekjet individuale të studiuesve, ndërkohë që në Ballkan, kjo fushë është e menaxhuar dhe e mirorganizuar nga institucionet shtetërore që e nxisin dhe e mbështesin atë, nëpërmjet instituteve, universiteteve dhe qendrave të specializuara kërkimore. Kjo metodë menaxhimi, thoshte dr. Kaleshi, siguron një ritëm dhe nivel më të mirë akademik për fushat kërkimore; krijon një klimë më të mirë për

kërkimet studimore; i kursen kohë të çmuar studiuesit apo kërkuesit shkencor, sidomos në gjetjen e burimeve dhe bibliografive të domosdoshme, pasi zakonisht një studiues i ri në përvojë, këtë punë e kryen fillimisht në qendra të ngjashme me të sipërpërmendurat. Po ashtu, kjo metodë menaxhimi siguron një planifikim të studiuar mirë të fushës kërkimore, sipas nevojave akademike dhe shkencore, gjithmonë në një fokusim gjithpërfshirës dhe me pikësynim të qartë në realizimin e projekteve të mëdha në interes të kërkimit shkencor.

Përktheu: Eris Koliqi